



Bursa për studime një semestrale në universitetet gjermane

Programi i bursave “COPERNICUS” ndanë bursa për studime një semestrale në universitetet gjermane të Munihut, Hamburgut dhe Berlinit. Pas përfundimit të semestrit, studentëve ju mundësohet edhe punë praktike dymujore në institucionet apo kompanitë prestigjioze të Gjermanisë.

Studentët e interesuar duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë studentë të drejttimeve të juridikut, ekonomisë ose shkencave sociale
- të kenë të kompletuar të paktën 4 semestra të studimeve të tyre
- të kenë mesatare të lartë të notave
- certifikatë apo dëshmi për zotërimin e gjuhës gjermane

Bursat nga ky program mbulojnë shpenzimet e udhëtimit, transportit publik në Gjermani, akomodimin në familjet mikpritëse gjermane, sigurimin shëndetësor-social dhe mjete shtesë për shpenzime tjera.

Afatet e fundit për aplikim në vitin akademik 2010/2011 janë:

- për semestrin që fillon më 1 Tetor 2010, afati i fundit për aplikim është 1 Mars 2010
- për semestrin që fillon më 1 Prill 2011, afati i fundit për aplikim është 1 Shtator 2010

Informacione shtesë mund të merrni në ueb-adresën: www.copernicus-stipendium.de ose adresën elektronike: stip-bewerbung@copernicus-stipendium.de

Për informacione më të detajuara, drejtohuni në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë – QESHK.